

MERRNI E HANI...



MERRNI E PINI...

# Jeta Liturgjike

Viti II Nr. 22, Tetor 2006



*IN MEMORIAM*  
*Don JAKË PRENKA*  
*(1943 - 2006)*

## In memoriam Don Jakë Prenku

30.X.1943 13.IX.2006

Don Jaku lindi në Janjevë më 30.X.1943 nga prindërit Mark dhe Kata Prenku. E pagëzuan në Janjevë më 3.XI.1943. Më pas familja shpërngulet në Ferizaj. Shkollimin fillorë e kryen në Ferizaj. Duke e ndjerë zërin e Krishtit: *Eja pas meje!* Don Jaku i përgjigjet me gatishmëri dhe kështu gjimnazin klasik e kryen në Pazinë. Pastaj studimet teologjike i fillon në Gjakovo të Kroacisë dhe i përfundon në Romë.

Xhakonatin e merr në Bishtazhin më 1972 nga Mons Nikë Prela. Ndërsa shugurimin meshtarak bashkë me të ndjerin don Gjergj Berisha e marrin në Ferizaj më 22.VII.1972, poashtu nga Mons Nikë Prela. Meshën e parë e kremton në Ferizaj më 23.VII.1972.

Shërbimi meshtarak: Veprimtarinë meshtarake e fillon si kapelan në Prizren, për të kaluar më pastaj në Zllakuqan 1972-1973 po ashtu si kapelan. Më pas shërben si famullitar në Stubëll deri në gusht të vitit 1989. Lirisht mund të themi se këtu don Jaku i tregoi të gjitha aftësitë dhe cilësitë e veta si një njeri tërësisht i kushtuar Zotit. Don Jaku në famullinë e Stublles u cilësua për dy veprimtari kryesore: Punoi shumë në infrastrukture. Rregulloi kishën e vjetër të shën Gjergjit, riparoj kishën e re të Shën Jozefit, inicioi dhe përkrahi asfaltimin e rrugës në Stubëll, e shtroi në kallderm rrugën nëpër fshat. Por mbi të gjitha don Jaku ndikoi pozitivisht në thirrjet e shumta meshtarake dhe rregulltare. Më tepër se gjysma e meshtarëve të Stubllës dhe shumë murgesha kanë marrë rrugën e Zotit me përkrahjen dhe ndihmën e don Jakut.

Pastaj dy vite shërben si bashkëpunëtor i famullitarit në Pejë. Nga v. 1991 deri në v. 1994 është ndihmës famullitar në Klinë. Që nga viti 1994 e deri në vdekje ishte

famullitarë në Mitrovicë. Zoti dhe don Jaku e dine se në çfarë kushtesh ka shërbyer në këtë qytet të ndarë. Ai me fuqitë e veta u mundua të jetë simbol i paqes, i afrimit, i krijimit të urave të reja në këtë qytet. Don Jaku ynë kishte një fat të keq familjarë. Herët i vdes babai. Ndërsa nëna i mbetet me vëllain me të meta psikike. Motrat i martohen dhe nuk patën ndonjë sukses familjarë. Para disa viteve në një fatkeqësi komunikacioni i vdesë vëllai dhe nëna dhe don Jaku që ishte me ta mrekullisht shpëton. Në janar të këtij viti i vdesë edhe motra, kështu që mbeti vetëm pa askënd të familjes së ngushtë. E keqja tjetër që e përcolli don Jakun një kohë të gjatë ishte sëmundja e rendë e sheqerit, tensionit etj. Por don Jaku nuk u dorëzua. Ai, ishte bashkëpunëtorë i zellshëm i revistës *Drita*, me artikuj të shumtë mbi ekumenizmin, dhe tash së fundi i *Jetës Liturgjike*. Por, don Jaku si një njeri solidar, gazmorë, edhe pse me shëndet të ligë, vazhdimisht bashkohej me vëllezërit meshtarë në festa të ndryshme. Kështu ai erdhi edhe në Letnicë, për herë të fundit për t'u përshëndetur me vëllezërit meshtarë në ditëlindjen e Zojës së Bekuar. Dhe një javë pas ia dorëzon shpirtin Zotit. Jam thellësisht i bindur se të mërkurën pas dite me 13.IX.2006. don Jaku ka thënë bashkë me Shën Palin: Luftën e mirë e luftova, vrapimin e krevës, fenën e ruajta, dhe tani më pret kurora e drejtësisë e përgatitur për ata që i mbesin besnik Zotit. Edhe varrimi, i tij, në Ferizaj, i udhëhequr nga Mons Zef Gashi dhe gjithë kleri ynë me rregulltarë, në festën e Lartësimit të Kryqit ka domethënie të vet. Zoti e shpërbleftë për mundin dhe kryqet e shumta që i pati gjatë jetës. Pushoftë në paqe.

Don Albert **DEMAJ**

## E Diela XXVI gjatë vitit

*Kush nuk është kundër nesh, është me ne!*

**Leximi i parë:** *Nr 11, 25 29.* Lexojmë se si populli dhe individët profetizojnë. Të profetizosh, në Bibël, do të thotë të jesh lajmëtar i Zotit, të shpjegosh fjalën e Zotit me gëzim dhe dashuri, i frymëzuar nga Shpirti i Zotit.

**Psalmi:** *19 (18) Urdhërimet e Zotit japin gëzim.*

**Leximi i dytë:** *Jak 5, 1-6.* Për të pestën të diele rresht dëgjojmë Shën Jakobin apostull, i cili nuk na i shpjegon fshehtësitë e fesë sonë, por atë çka besimi ynë kërkon prej nesh, gjegjësisht çka ne bëjmë me fe për vëllain njeri.

**Ungjilli:** *Mk 9,38-43.45. 47-48.*

*Në atë kohë, Gjoni i tha Jezusit: “Mësues, e pamë një njeri që i dëbonte djajtë në Emër tënd. Ne ia ndaluam, sepse ai nuk na ndiqte.” Jezusi tha: “Mos ia ndani! Sepse s’ka njeri që të mund të bëjë mrekulli në Emrin tim e menjëherë pastaj të flasë keq për mua. Kush nuk është kundër nesh, është me ne. Ai që do t’ju japë të pini një gotë ujë përse jeni të Krishtit, për të vërtetë po ju them: me siguri nuk do ta humbë shpërblimin e vet. Porse, për atë që mëson ndonjërin prej këtyre të vegjëlve që besojnë në mua të mëkatojë, do t’ishite më mire t’i varej rreth qafës guri i mullirit e të hidhej në det. Prandaj, nëse dora jote të çon në mëkat, preje! Më mire është për ty të hysh dorëcung në jetë se me të dy duart të shkosh në ferr në zjarr që s’fiket kurrë. E nëse këmba jote të çon në mëkat, preje! Më mire është për ty të hysh në jetë i çalë se t’i kesh të dy këmbët e të hidhesh në ferr. Po qe se edhe syri yt të çon në mëkat, nxirre! Më mire është për ty të hysh në Mbretërinë e Hyjit me një sy se t’i kesh të dy e të hidhesh në ferr. Ku krimbi i tyre nuk cof e zjarri nuk fiket.”*

**Fjala e Zotit**

Jean Jacques Rousseau (Zhan Zhak Ruso), shkrimtar dhe filozof i njohur francez, por fatkeqësisht, ai është i njohur edhe si ateist. Ai vet e pranon se si ka ardhur deri te kjo. Nena i kishte vdekur gjate lindjes, dhe pas vetit kishte lënë një numër të madh librash e romanësh me përmbajtje te keqe. Kur u rrit djaloshi filloi për t’i lexuar këto libra, të cilat negativisht ndikuan në formimin e tij ndaj besimit.

Nuk di a ka ne bote njeri qe mund te behet vetvetiu aq i çoroditur pa ndihmën e të tjerëve?! Njeriu nuk lind kriminel! Pra, nëse një fëmijë bëhet i tillë, atëherë atë e ka mësuar familja ose rrethi ku ai jeton. Thonë se majmuni ka dëshirë te shikoje se si vepron njeriu, për të imituar atë. Po ashtu edhe fëmijët dëshirojnë t’i shikojnë të rriturit se si veprojnë, por edhe t’i imitojnë.

Ju, vëllezër e motra, keni kujdes kur bisedoni qoftë edhe në mahi, sidomos kur afër jush gjenden fëmijët, sepse edhe mahia me e vogël mund të ndikojë negativisht tek fëmijët, kur është fjala për të keq. Le te themi figurativisht: A thua nuk do të brente ndërgjegjja tërë jetën, sikur fëmiut tënd, pa dashje apo nga pakujdesia t’ia presësh gishtin? Sigurisht se po! Atëherë pse fëmiun tënd me dashje e drejton ne rruge te gabuar duke i dhënë shembull te keq?! Mos të çuditemi nëse fëmiu sillet keq, por lë të pyesim vetveten: Pse di të shajë fëmiu yt, kush e ka mësuar të gënjejë, pse është agresivë? Pse i themi të gjitha këto? Krishti ne Ungjillin e sotëm, ketë gjë e thekson me këto fjale: *Porse, për atë që mëson ndonjërin prej këtyre te vegjëlve qe besojnë ne mua të*

*mëkatojë, do të ishte me mire t'i varej rreth qafës guri i mullirit e te hidhej ne det* (Mk 9,42). Andaj, vëllezër e motra, kur te vie për te sharë ndokënd, e përreth te dëgjojnë fëmijët, mendo ne fjalët e Krishtit. Mos harro: në botë ka pasur dhe ka njerëz te cilët më me dëshirë kishin për të vdekur se sa t'i shkandullonin të tjerët. Krishti nuk na tërheq vërejtjen vetëm neve që të mos bëjmë vepra të pahijshme, por ai na bën me dije, se duhet te kemi kujdes që të mos e shkatërrojmë shpirtin e tjetërkujt, me çka do të shkatërronim edhe shpirtin tonë. Krishti ka thënë: *Prandaj, nëse dora jote të çon ne mëkat, preje! Me mirë është për ty të hysh dorëcung në jetë se me të dy duart të shkosh në ferr në zjarr që s'fiket kurrë...* (Mk 9,43-48) A thua e kuptojmë pse Krishti thotë kështu? Njeriut i dhimbset syri, i dhimbset secili gisht, e si mos t'i dhimbset tërë dora apo trupi!? Por, kur i rrezikohet jeta, atëherë njeriu flijon njërin sy për ta shpëtuar tjetrin, flijon njërin dorë, njërin këmbë ose te dyjat për të shpëtuar jetën. Flijon dhe vuan aq shumë, për të jetuar me gjatë dhe në fund prap do të vdesë. Kur papritmas bëhet vërshimi, shpërthen zjarri ose ndonjë fatkeqësi tjetër, e nëse nuk ka mundësi t'i shpëtosh të gjitha gjërat, atëherë mundohesh t'i shpëtosh ato që janë të vlefshme dhe më të nevojshme. E atëherë kur nuk je në gjendje të shpëtosh ndonjë send tjetër, atëherë do te jesh i lumtur nëse e shpëton veten dhe fëmijët. Kështu, pra, njeriu duhet te jetë i gatshëm për të flijuar shumë çka qe të shpëtoj shpirtin dhe të fitojë jetën e pasosur. Nëse e shpëton shpirtin ke arrit t'i shpëtosh gjerat më te çmuara, ia ke arrit qëllimit kryesor. Duaj sytë e tu, duaj duart tua, këmbët tua! Trupi ynë duhet dashur dhe ruajtur, por më i vlefshëm se trupi është shpirti. Nëse ne aq shumë kujdesemi dhe shpenzojmë për

mirëmbajtjen e trupit, i cili në fund të fundit do të përfundojë në varrë, sa më tepër duhet kujdesur për shpirtin, i cili është i pavdekshëm..

Vëllezër dhe motra, duhet të jemi vigjilent, të kujdesshëm, mos ndokush për shkak të sjelljeve tona të këqia, ka humbur besimin në Zotin, pafajësinë dhe paqen e shpirtit Mëkati është i pranishëm në jetën tone, diku më shumë e diku më pak. Sa ne e luftojmë atë? Sa ne jemi përgjegjës për mëkatet e tjerëve? Te lumtë ne, nëse asnjë shpirt nuk e kemi nxitë, bindur apo drejtuar ne rrugën e mëkatit me vepra apo me sjelljet tona. Amen.

### **Lutjet e besimtarëve**

**Vëllezër dhe motra, të falënderojmë Krishtin Zot, i cili në çdo meshë shenjte na ushqen me fjalën dhe me korpin e vet, dhe t'ia drejtojmë lutjet tona: O Krisht, na shenjtëro.**

- Për Papën Benediktin e XVI, ipeshkvijtë, meshtarët, e rregulltarët, që të punojnë palodhshëm në predikimin e ungjillit, *të lutemi.*
- Që ipeshkvisë sonë t'ia caktosh një ipeshkëv që do të dijë të na udhëheq drejt Teje, *të lutemi.*
- Për prindërit, që t'i edukojnë fëmijët me fjalë dhe me vepra të mira, *të lutemi.*
- Për shpirtin e meshtarit tonë don Jakut, që e thirre nga kjo jetë tek Ti, pranoje në Mbretërinë tënde, *të lutemi.*

**O Hyj që me përvujtërimin e Birit tënd e ngrite botën që pati rënë poshtë, jepu besimtarëve të tu gëzimin e shenjtë dhe ndihmën për shëlbimin e shpirtit. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.**

Don Tomë **KARRICA**

## E Diela XXVII gjatë vitit

*Çka bashkoi Hyji, njeriu të mos guxojë të ndajë!*

**Leximi i parë:** *Zan 2, 18-24.* Para Zotit, mashkulli dhe femra, burri dhe gruaja, janë njësojë të barabartë, që plotësohen mes veti, në aspektin fizik dhe shpirtërorë.

**Psalmi:** *128 (127) Na bekoftë Zoti, burimi i jetës.*

**Leximi i dytë:** *Heb 2, 9-11.* Fshehtësi e madhe është dashuria e Zotit, është fat dhe ngushëllim për ne njerëzit që Zoti ynë është bërë vëllau ynë. Shumë pak jemi të vetëdijshëm se Shëlbuesi ynë nga kryqi është shpëtimtari ynë.

**Ungjilli:** *Mk 10,2-16.*

*Atëherë iu afruan farisenjtë e, për ta sprovuar, e pyetën: “A ka leje burri ta lëshojë gruan?” Ai iu përgjigji: “Çka ju urdhëroi Moisiu?” Ata i përgjigjën: “Moisiu lejoi të shkruhet letra e ndarjes e të lëshohet.” Jezusi u tha: “Atë rregullore e shkroi për ju Moisiu për arsye të kryeneçësisë suaj. Por në fillim të botës, Hyji i krijoi mashkull e femër. Prandaj njeriu do ta lërë babanë e vet e nënën e vet e do të bashkohet me gruan e vet, e kështu të dy do të jenë një trup i vetëm. Këndeji pra, nuk janë më dy, - por një trup i vetëm. Prandaj, çka bashkoi Hyji, njeriu të mos guxojë të ndajë!” Në shtëpi nxënësit e pyetën përsëri për të njëjtën gjë. Ai u tha: “Kush e lëshon gruan e vet e merr një tjetër, bën kurorëthyerje kundër të pares. Po qe se edhe gruaja e lëshon burrin e vet e martohet me një tjetër, bën kurorëthyerje.” Ia sillnin fëmijët që të vinte dorën mbi ta, por nxënësit ua ndalonin. Jezusi, kur i pa, i erdhi keq dhe u tha: “Lini fëmijët të vijnë tek unë e mos i daloni; sepse atyre u përket Mbretëria e*

*Hyjit! Përnjëmend po ju them: kush nuk e pranon Mbretërinë e Hyjit porsia fëmija i vogël, nuk do të hyjë në të.” Atëherë i mori fëmijët ngrykë dhe i bekoji duke vënë duart mbi ta.*

### Fjala e Zotit

Tema kryesore e leximeve të sotit është kurora gjegjësisht familja. Familja sipas planit të Zotit duhet të jetë vatër e paqes dhe dashurisë për të gjithë anëtarët e familjes. Pra, lirisht mund të themi se familja është elementi kryesorë prej të cilit varet ardhmëria e Kishës dhe e popullit. Ajo është bërthama, qeliza e shoqërisë. Nëse ajo është e shëndoshë, e shëndoshë është edhe shoqëria, Kisha. Dhe e kundërta, nëse ajo është e sëmurë, i sëmurë është kombi dhe kisha, të cilët



nuk do të kenë ardhmëri. Sot ta pyesim secili vetveten: Si është puna me familjen time? Është ajo e lumtur? Familja ime është kishë dhe shkollë, ku fëmijët bashkë me hapat e parë i mësojnë edhe virtytet tjera fetare dhe kombëtare, që ata nesër do t'i bëjnë fetarë dhe kombëtarë të mire, me të cilët do të mburremi të gjithë? Nderohet Zoti në familjen time? Jam faktor i paqes, i bashkimit në familjen time? Gëzohen familjaret kur unë kthehem në shtëpi? Çka mund të bëj unë që në familjen time gjithçka të jetë në rregull? *Familja është mrekulli kur është e shenjtë, dhe e mallkuar, kur është e shkatërruar!* (P Mijo Shkvorc). Çfarë është familja jote?

E lumja Nëna jonë Tereze, në



porosinë e vet drejtuar popullit tonë thoshte: *Ruani familjet tuaja. Mos i bashkoni anëtarët e familjes suaj vetëm për të ngrënë, argëtuar dhe dëfryer, por edhe në uratë. Lutne rruzarën në familjet tuaja!*

Pra, vëllezër dhe motra, që familjet tona të jenë të bashkuara, nuk është vetëm dëshira e të martuarve, por edhe e Zotit. Andaj le të mundohemi për të realizuar dëshirën e Zotit dhe amanetin e Nënës sonë Tereze. Ta lusim rruzarën në familjet tona, t'i ruajmë familjet tona. Dhashtë Zoti që familjet tona të jenë vatër e paqës, dashurisë, diturisë. Amen.

Lutjet e besimtarëve

Besimtarë të dashur, para se t'ia paraqesim Zotit dhurata tona, bukën dhe verën, të cilat do të shndërrohen në kordin dhe gjakun e Krishtit, t'ia paraqesim Atij lutjet tona duke thënë: ***Dëgjoje, o Zot, lutjen tonë.***

- Për Kishën Katolike, anekënd botes, që si një familje e madhe të jetë e bashkuar dhe e forte, *të lutemi.*

- Për misionaret, që me ndihmën Tënde të predikojnë palodhshëm Lajmin e gëzueshëm, *të lutemi.*

- Për familjet tona, të jenë vatër e paqes, dashurisë, solidaritetit, mirësisë dhe faljes, *të lutemi.*

- Për ato familje që janë në rrezik të shkatërrohen, ndihmoju të vijnë deri tek afrimi dhe bashkimi, *të lutemi.*

- Për prindërit të cilët duke përdorur alkoolin, rrezikojnë mirëqenien familjare, që duke e lënë alkoolin të kujdesen për familjet e veta, *të lutemi.*

**O Atë, Krijuesi ynë, dhuroju paqen familjeve tona, nëpër Krishtin Zotin tone. Amen.**

Don Kolë ZEFI

## ENGJËJT

Ekzistenca e engjëjve një e vërtetë e fesë

**328** Ekzistenca e qenieve shpirtërore, jotrupore, që Shkrimi Shenjt i quan zakonisht engjëj, është një e vërtetë feje. Dëshmimi i Shkrimit shenjt është po aq i qartë sa dhe njëzëshmëria e Traditës.

Kush janë Engjëjt?

**329** Shën Augustini thotë në lidhje me ta: *Fjala engjëll shënon shërbesën, jo natyrën. Po të kërkohet emri i kësaj natyre përgjigjemi se është shpirt; po të kërkohet shërbesa, përgjigjemi që është engjëll: është shpirt për atë që është, ndërsa për ato që kryen është engjëll.* Në të gjithë qenien e tyre, engjëjt janë shërbyes dhe lajmëtarë të Zotit. Për faktin që e *shohin vazhdimisht fytyrën e Atit tim qiellor* (Mt 18, 10), ata janë *zbatues të fuqishëm të urdhrave të tij, duke i dëgjuar urdhrat e tij* (Ps 103, 20).

**330** Si krijesa thjesht *shpirtërore*, ata kanë arsye dhe vullnet: janë krijesa vetjake (personale) dhe të pavdekshme. Ua kalojnë për nga përsosmëria të gjitha krijesave të dukshme. Këtë e dëshmon shkëlqimi i madh i lavdisë së tyre.

Krishti «me të gjithë engjëjt e vet»

**331** Krishti është qendra e botës engjëllore. Ata janë «engjëjt e tij»: *Kur të vijë Biri i njeriut në madhërinë e vet e me të gjithë engjëjt...* (Mt 25, 31). I ka të vetët sepse janë krijuar *nëpërmjet tij dhe për të: Sepse në Të u krijua çdo gjë në qiell e në dhe, çka shihet e çka nuk shihet: qoftë Tronet, qoftë Zotërimet, qoftë Principatat, qoftë Pushtetet gjithçka u krijua nëpër Të dhe për Të* (Kol 1, 16). I ka të vetët edhe më tepër sepse i ka bërë lajmëtarë të planit të vet të shëlbimit: *A nuk janë thua të gjithë engjëjt shpirtra të ngarkuar me ndonjë*

*shërbim, të dërguar për të shërbyer ata që do ta trashëgojnë shëlbimin?* (Heb 1, 14).

**332** Ata, që nga krijimi dhe gjatë gjithë historisë së shëlbimit, lajmërojnë nga larg dhe nga afër këtë shëlbim dhe i shërbejnë realizimit të planit shpëtimtar të Zotit: mbyllin parajsën e tokës, mbrojnë Lotin, shpëtojnë Agarën dhe fëmijën e saj, i ndalin dorën Abrahamit; Ligji mirret prej duarve të engjëjve (Vap 7, 53), ata udhëheqin Popullin e Zotit, lajmërojnë lindje dhe thirrje; ndihmojnë profetët, për të cituar këtu vetëm disa shembuj... Më në fund, Engjëlli Gabriel lajmëron lindjen e Paraardhësit dhe atë të vetë Jezusit.

**333** Që nga Mishërimi dhe deri te Ngritja në Qiell, jeta e Fjalës së mishëruar rrethohet nga adhurimi dhe shërbimi i engjëjve. Kur Zoti *e shtie Njëlindurin Birin e vet në botë, thotë: le ta adhurojnë të gjithë engjëjt e Hyjit!* (Heb 1, 6). Kënga e tyre e lavdërimit për lindjen e Krishtit nuk ka pushuar të jehojë në lavdërimin e Kishës: «Lavdi Hyjit në lartësitë qiellore...» (Lk 2, 14). Ata mbrojnë fëmijërinë e Jezusit, i shërbejnë Jezusit në shkreti, e ngushëllojnë gjatë agonisë, kur ai kishte mundësi të shpëtohej prej tyre nga duart e armiqve, ashtu si dikur Izraeli.. Prapë janë engjëjt ata që *ungjillëzojnë* (Lk 2,10) duke lajmëruar Lajmin e Mirë të Mishërimit dhe të Ngjalljes së Krishtit. Me kthimin e Krishtit, që ata e lajmërojnë, do të jenë të pranishëm aty, në shërbim të gjyqit të tij.

Engjëjt në jetën e kishës

**334** Në të njëjtën mënyrë e gjithë jeta e Kishës përfiton nga ndihma e mistershme dhe e fuqishme e engjëjve.

**335** Në liturgji, Kisha bashkohet me engjëjt për të adhuruar Zotin tri herë të shenjtë; i bën thirrje ndihmës së tyre (kështu në «Supplices te rogamus...» «Përvujtërisht po të lutemi...» të Kanonit romak, ose «In Paradisum deducant te angeli...» «Në Parajsë të shoqërofshin engjëjt në Ritin e varrimit, po ashtu edhe në «Himnin e Kerubinëve» (të Liturgjisë bizantine), dhe kremton kujtimin e disa engjëjve në veçanti (shën Mihilli, shën Gabrieli, shën Rafaeli, Engjëjt Rojës).

**336** Që nga fëmijëria deri në çastin e vdekjes jeta njerëzore rrethohet nga mbrojtja e tyre dhe ndërmjetësimi i tyre. *Çdo besimtar ka përbri vetes një engjëll, si mbrojtës dhe si bari, për ta drejtuar në jetë;* Që këtu mbi dhe, jeta e krishterë merr pjesë, në besim, në bashkësinë e lume të engjëjve dhe të njerëzve, të bashkuar në Zotin.

## II. Rënia e engjëjve

**391** Prapa zgjedhjes që bënë prindërit tanë për të mos u bindur është një zë mashtrues, që i kundërvihet Zotit, i cili, nga smira, i bën që të bien në vdekje. Shkrimi dhe Tradita e Kishës shohin në këtë qenie një engjëll të rënë, të quajtur Satana ose djall. Kisha mëson se ai në fillim kishte qenë një engjëll i mirë, i krijuar nga Zoti. *Në të vërtetë djalli dhe demonët e tjerë janë krijuar nga Zoti me natyrë të mirë, por ata vetë u shndërruan në të këqij.*

**392** Shkrimi flet për një *mëkat* të katyre engjëjve. Kjo *rënie* lidhet me faktin që këta shpirtra të krijuar, me një zgjedhje të lirë nga ana e tyre, *e kanë hedhur poshtë* (e kanë refuzuar) në mënyrë rrënjësore dhe

të prerë Zotin dhe Mbretërinë e tij. E gjejmë një pasqyrim të kësaj kryengritjeje në fjalët që i drejton tunduesi prindërve tanë të parë: *Do të bëheni porsì Hyji* (Zan 3, 5); *djalli mëkaton qysh prej fillimit* (1 Gjn 3, 8), *baba i rrenës* (Gjn 8, 84).

**393** Fakti që mëkati i engjëjve nuk mund të falet buron nga vetë karakteri i prerë (i patërheqshëm) i zgjedhjes së tyre dhe jo nga ndonjë mungesë e mëshirës së pafundme të Zotit. *Nuk ka mundësi pendimi për ta pas rënies, ashtu si nuk ka mundësi pendimi për njerëzit pas vdekjes.*

**394** Shkrimi dëshmon ndikimin e kobshëm të atij që Jezusi e quan *vrapar njerëzish që në fillim* (Gjn 8,44) dhe që ka arritur deri aty sa të përpiquej ta shkëpuste Jezusin nga misioni që i kishte besuar Ati. *Biri i Hyjit u shfaq që t'i zhbijë veprat e djallit* (1 Gjn 3, 8). Nga këto vepra, më e rënda për pasojat e saja ka qenë joshja gënjeshtare që e ka shtyrë njeriun të mos i bindet Zotit.

**395** Porse fuqia e Satanait nuk është e pafundme. Ai nuk është veçse një krijesë, e fuqishme për faktin se është shpirt i kulluar, por prapëseprapë një krijesë: nuk mund ta ndalojë ndërtimin e Mbretërisë së Zotit. Megjithëse Satanai vepron në botë për inat kundër Zotit dhe Mbretërisë së tij në Krishtin Jezus, dhe megjithëse veprimi i tij shkakton dëme të rënda të natyrës shpirtërore dhe tërthorazi edhe të natyrës fizike për çdo njeri dhe për shoqërinë, ky veprim lejohet nga Provania hyjnore, e cila e drejton historinë e njeriut dhe të botës me forcë dhe butësi. Lejimi hyjnor i veprimtarisë së djallit është një mister i madh, por *ne e dimë se Hyji në gjithçka bashkëpunon me ata që e duan* (Rom 8, 28).

*Pjesë nga: Katekizmi i Kishës Katolike (KKK)*

## E Diela XXVIII gjatë vitit

*Shit çka ke e atëherë kthehu e eja pas meje!*

**Leximi i parë:** *Urt 7, 7-11.* Na flet për urtinë, e cila po i mungon botes moderne. Leximi na e paraqet edhe rolin e lutjes, sepse me lutje mund të arrihet gjithçka.

**Psalmi:** *90 (89) Na e jep, o Zot, urtinë e zemrës.*

Leximi i dytë: *Heb 4,12-13.* Shën Pali në letrën e vet drejtuar Hebrenjëve e veçon veçmas Fjalën e Zotit që është e gjallë dhe vepruese. Fjala e Zotit është ajo që jep jetën.

**Ungjilli:** *Mk 10, 17-30*

*Në atë kohë, kur Jezusi doli në rrugë, një njeri u lëshua vrap, ra në gjunjë para tij dhe e pyeti: “Mësues i mire, çka duhet të bëj për të fituar Jetën e pasosur?” Jezusi i përgjigji: “Pse më thua: i mire? Askush s’është i mire përveç Një Hyji të vetëm! Urdhërimet i di: Mos vrit! Mos the kurorën! Mos vidh! Mos dëshmo rrejshëm! Mos bëj kurrfarë padrejtësie! Ndero babën tënd e nënën!” Ai u përgjigji: “Mësues, të gjitha këto i kam zbatuar që prej rinisë sime.” Atëherë Jezusi e shikoi ëmbël, i pëlqeu dhe i tha: “Të mungon edhe një gjë: shko shit çka ke, ndajau skamnorëve e do të kesh thesar në qiell; atëherë kthehu e eja pas meje!” Djaloshi u prish kur dëgjoi këtë fjalë dhe, i trishtuar, u largua, sepse kishte prona të shumta. Jezusi, pasi e hodhi shikimin për rreth, u tha nxënësve të vet: “Sa vështirë do të hyjnë pasanikët në Mbretërinë e Hyjit.” Nxënësit mbetën shtang të habitur prej këtyre fjalëve të tija. Por Jezusi foli përsëri dhe u tha: “Bijtë e mi! Sa vështirë është të hyhet në Mbretërinë e Hyjit! Më lehtë është të përshkohet devja nëpër veshë të gjilpërës se të hyjë i pasuri në Mbretërinë e Hyjit!” Nxënësit çuditëshin edhe më tepër dhe i*

*thoshin njëri tjetrit: “Atëherë kush do të shëlbohet?” Jezusi ua nguli sytë dhe tha: “Sa për njerëz, njëmend është punë që s’bëhet, por jo për Hyjin, Hyji mund të bëjë gjithçka.” Atëherë Pjetri mori fjalën e i tha: “Qe, ne lame çdo gjë e erdhëm pas teje.” Jezusi i përgjigji: “Për të vërtetë po ju them: s’mund të ketë njeri që la për shkak timin e për shkak të Ungjillit shtëpinë, ose vëllezërit, ose motrat, ose nënën, ose babën, ose fëmijët, ose arat e të mos marrë tani në këtë botë, edhe pse me salvime njëqind here aq shtëpi, vëllezër, motra, nëna, fëmijë e ara e në botën e ardhshme Jetën e pasosur.”*

**Fjala e Zotit**

Jezusi tha një herë: *Ku është thesari yt, aty do të jetë edhe zemra jote.* Kjo do të thotë me fjalë të tjera: ne e delegojmë zemrën tonë aty ku në të vërtetë e shohim qëllimin tonë, në çdo vlerë për të cilën jetojmë. Kjo mund të jetë një gjë sikur njeriu që e shkatërron pasurinë e vet, mund të jenë vlera të caktuara, mund të jetë një detyrë, mund të jetë një njeri shumë i dashur - mirëpo në çdo rrethanë, thesari i jetës sonë mund dhe duhet të jetë: Zoti. Është e mundshme të jetojmë me Zotin, sepse vet Zoti këtë na e mundëson. Ai është i mirë dhe na jep këtë mundësi shpirtërore të bashkëjetesës me të. Për këtë arsye duhet që për çdo ditë të besojmë duke mësuar dhe të mësojmë duke besuar. Edhe shenjtërit para nesh shkuan kësaj rruge, sepse *ku është thesari yt, aty do të jetë edhe zemra jote.*

Jezusi i thotë djaloshit pasanik: *Të mungon edhe një gjë: shko, shit çka ke,*

*ndajau skamnorëve e do të kesh thesar në qiell; atëherë kthehu e eja pas meje!* Kështu Krishti e sprovon djaloshin sa është i aftë të përcaktohet për Krishtin dhe të dëshmojë se ku është zemra e tij. *Thirrja* për të shkuar pas Jezusit, vlen për të gjithë ata që besojnë në Jezusin. Por, nuk janë të gjithë të thirrur në të njejtën formë dhe në të njëjtin vend. *Thirrja* e jonë është: *ta hapim zemrën tonë për Zotin dhe për të afërmin tonë.* Kjo është zemra e hapur për dashuri, që ne besojmë në të mirën dhe me ndihmën e Zotit e konkretizojmë në jetën tonë. *Kush beson dhe dashuron, ai guxon edhe të shpreson!* Këtu vërejmë se njeriu nuk është diçka në saje të asaj që *ka*, por në saje të asaj që *është!*

*Sa vështirë do të hyjnë pasanikët në Mbretërinë e Hyjit!* Këto fjalë të Jezusit na bëjnë të mendojmë se në çfarë mënyre duhet arritur mbretëria e qiellit? Duhet njeriu ndoshta të jetë i pasur me gjëra materiale, që të jetë i varfër në Zotin, apo i pasur me Zotin, duke qenë i varfër në jetë?! Pra, çka dmth të jesh i pasur? Pasuria në aspektin teologjik është bashkëjetesa me Zotin, kur ne e arrijmë shëlbimin dhe arritjen në mbretërinë qiellore. Dikush mund të thotë ndoshta: nëse unë i kam të gjitha të mirat e kësaj bote, atëherë çfarë me duhen ato qiellore? *Ku është thesari yt, aty do të jetë edhe zemra jote.* Ku është thesari i jetës sime? Kush mund të shëlbohet? Këto pyetje ndoshta nuk mund të kuptohen apo nuk ka përgjigje, por e kemi një përgjigje të përforsimit dhe të ngushëllimit, që thotë: *Sa për njerëz, njëmend, është punë që s'bëhet, por jo për Hyjin, Hyji mund të bëjë gjithçka.* Zoti nuk kërkon asgjë prej nesh, përveç që të kemi besim, shpresë dhe të lejojmë që ta përqafojmë atë në jetën tonë, sikur fëmiju që përqafon të ëmën e vet me

shpresë dhe dashuri fëmijërore. Nëse ne e bëjmë këtë me dashuri dhe me lutje, atëherë jemi njerëz të lirë dhe të pasur. Jezusi kërkon edhe prej nesh sot dhe gjithmonë, që të heqim dorë nga të gjitha gjërat që na pengojnë për të bashkëjetuar dhe bashkëpunuar me Zotin. Në këtë mënyrë ne marrim formën e *shpirtit të varfër* që të mund të hyjmë në mbretërinë qiellore të pasur. Zoti dëshiron që ne të jemi të lirë për të dhe për njeriun.

Pra, le të kemi forcë dhe shpresë, që t'i hapim zemrat tona për Zotin dhe njeriun. Mos të na kaplojë urrejtja, egoizmi, materializmi, por ta hapim zemrën për fe, shpresë dhe dashuri! Amen.

### **Lutjet e besimtarëve**

**Besimtarë të dashur, t'i drejtohem i Atit tonë, që kujdeset për ata që krijojnë dhe shpërbleu nëpërmjet Birit të vet: Forcoje besimin tonë, o Zot.**

- O Atë i mirësisë, drejtoji hapat tanë në rrugën e shenjtërimit, bëj që çdo herë të kërkojmë atë çka është e drejtë, e vërtetë, e pastër dhe e ndershme, *të lutemi.*
- Mos na braktisë, o Zot, as atëherë kur ne me mëkatet tona largohemi prej teje, *të lutemi.*
- Ndhimona që të kujdesemi edhe për pasuri shpirtërore, e jo vetëm materiale, *të lutemi.*
- Ata që besuan në Ty, e që i ke thirrë nga kjo jetë, pranojë në Mbretërinë tënde, *të lutemi.*

**Bëj, o Hyj i gjithëpushtetshëm, që ta shpallim fuqinë e Krishtit të ringjallur, kështu që sikurse e morëm pengun e dhuratës, të mund t'i fitojmë nëpër të dhuratat qiellore. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.**

Don Kolë **GJERGJI**

## E diela XXIX gjatë vitit

*Të jemi të palëkundshëm në dëshmimin e fesë!*

**Leximi i pare:** *Is 53,2,3.10-11* Na flet për vuajtjen e një njeriut të drejtë, vuajtja e të cilit nuk është e pakuptimtë Shërbëtori i Hyut.

**Psalmi 33 (32):** *Na e jep mëshirën tënde, o Zot, sepse në ty shpresojmë.*

**Leximi i dytë:** *Heb 4, 14-16.* Të jemi të palëkundshëm në dëshmimin e fesë!

**Ungjilli:** *Mk 10,35-45.*

*Në atë kohë, Jakobi e Gjoni, bijtë e Zebedeut, iu afruan Jezusit dhe i thane: “Mësues, dëshirojmë të bësh për ne çka po të kërkojmë.” “Çka dëshironi u tha Jezusi të bëj për ju?” Ata i thanë: “Bëj që në lavdinë tënde të rrimë njëri në të djathtën e tjetri në të majtën tënde.” Jezusi u përgjigji: “Nuk dini çka lypni. A jeni të zotët ta pini gotën që unë pi? Ose të pagëzoheni me atë pagëzim me të cilin unë pagëzohem?” “Jemi të zotët!” i përgjigjën ata. Jezusi vijoi: “Vërtet do ta pini gotën që unë pi dhe do të pagëzoheni me pagëzim me të cilin unë pagëzohem. Por të vë ndokënd të më rrijë në të djathtën ose në të majtën time kjo nuk është në pushtetin tim ta jap kjo gjë u përket atyre për të cilët është bërë gati.” Kur morën vesh dhjetë tjerët, u hidhëruan në Jakobin e në Gjonin. Prandaj Jezusi i thirri përreth dhe u tha: “Ju e dini se ata që mbahen për sundues të popujve, i sundojnë me ashpërsi dhe qeveritarët e tyre ushtrojnë mbi ta pushtetin e vet. Kështu veç, nuk duhet të jetë ndër ju. Përkundrazi, kushdo prej jush që do të jetë më i madh, le të bëhet shërbëtori juaj, dhe ai që prej jush do të jetë i pari, le të bëhet*

*skllavi i të gjithëve, sepse Biri i njeriut nuk erdhi për të qenë shërbyer, por që ai të shërbejë e ta jape jetën e vet si shpërblim për të gjithë.”*

### Fjala e Zotit

Të dielat e fundit kemi vërejtur se si nxënësit e shoqërojnë Jezusin drejtë Jerusalemit. Dëgjojnë mësimin e tij, këshillat e tija: Martesa, fëmijët, djaloshi pasanik, kurse ungjilli i sotëm i rikthehet nxënësve që janë më të afërmit e Jezusit. Po që duam ta kuptojmë më mirë ungjillin e sotëm, atëherë porosia është e dedikuar atyre që janë në shërbesën e Krishtit dhe të Kishës: papës, ipeshkvit, meshtarëve. Predikatari duhet i pari t'i dëgjojë rreshtat e ungjillit të sotëm para se ta ve në përdorim, kishte me thënë Shën Gjon Vianej. Por, ungjilli i sotëm, iu dedikohet të gjithë të pagëzuarëve në Jezu Krishtin, të gjithë duhet të jemi në shërbim të Zotit dhe vëllait njeri. Nuk mjafton të jemi vetëm të pagëzuar formalisht me ujë dhe Shpirtin Shenjtë, por duhet të gjithë të zhytemi në pagëzimin e Jezu Krishtit, duke kaluar nëpër mes vuajtjeve, mundimeve ose kryqit për të arritur deri te ngjallja, siç na porositë Shën Pali: *po a nuk e dini se të gjithë sa jemi pagëzuar në Jezu Krishtin, jemi pagëzuar në vdekjen e tij?* (Rom 6,3).

Jezusi për të tretën herë e zbulon se çfarë e pretë në Jerusalemin. Për nxënësit e tij e pakuptueshme. Do ta kuptojnë pas ngjalljes së Jezusit. Marku ungjilltar dëshiron ta ritheksoj se kush është Jezusi dhe identiteti i tij, që shfaqet nëpërmes

shërbesës, e që njëherë është edhe dëshmia e Kishës së hershme. Por, Marku në të njëjtën kohë i paraqet edhe pikat e dobëta të nxënësve, në veçanti bijtë e Zebedeut. Jezusi dëshiron që ta pengon kuptimin e gabuar për Mesinë, sepse identiteti i Mesisë nuk është në kuptimin e një çlirimtarit politik? Ndoshta nxënësit ishin të pirur për një gjë të tillë, sepse ishin infektuar nga politika ditore që manipulon me masat e njerëzve me idetë e shtrembëruara për Mesinë (Krahaso Mk 10,30-40).

Jezusi e kthen topin në tokë, duke u përgjigj: *Nuk dini çka lypni. A jeni të zotët ta pini gotën që unë e pi? Ose të pagëzoheni me atë pagëzim me të cilin unë pagëzohem?* Natyrisht ata ju përgjigjen pozitivisht, por ata ende nuk e kuptojnë se çfarë çmimi duhet të ndërmerren për të realizuar Misionin Shpëtimtarë: i përjashtuar nga populli i vetë, i brengosur

nga mosbesimi i tyre, i tradhtuar nga nxënësit e tij - Juda, djersitja që i rikthehet në gjak në Malin e Ullinjve, i vetmuar dhe i braktisur nga të gjithë. Kjo është ajo gota për të cilën Jezusi fletë. Këtë e pranojnë dy bijtë e Zebedeut, por nuk e dinë se çka i pretë. Dimë më vonë fatin e tyre. Gjoni nuk bëhet i pari prej apostujve, por Pjetri. I pari ndër apostuj, vdiq si martirë për Krishtin - Jakobi, vëllai i Gjonit, edhe ata që në agimin e

Kishës së hershme. Jezusi iu plotësoj premtimin e dhënë: pinë nga gota e Krishtit dhe pagëzohen me pagëzimin e tij. Porosia nuk është vetëm për Gjonin, Jakobin dhe apostujt, por edhe për neve sot: *kushdo prej jush që do të jetë më i madh, le të bëhet shërbëtori juaj, dhe ai që prej jush do të jetë i pari, le të bëhet skllavi i të gjithëve...* (Mk 10,43-45).

*Tregohet për një rabin, për të cilin flitej se për çdo ditë para lutjes së mëngjesit ngjitet në qiell. Një ditë shoku i tij, po ashtu rabin, vendosi ta përcjellë fshehurazi. Rabini i veshur me veshjet e punëtorit, me sopat në dorë shkojë në pyll. Nga larg e vëzhgonte rabini tjetër. Rabini i pret drutë dhe pasi i ngarkojë në shpinë, shkojë në shtëpinë e një plake, e cila ishte e sëmurë dhe vetëm. Nga dritarja e vëzhgon se çfarë bëri rabini në atë shtëpi. Pasi dhezi stufën dhe ia përgatiti dhomën, u kthye pastaj në shtëpinë e vetë dhe fillojë*

*lutjet e mëngjesit. Një ditë bashkëvendësit e pyeten rabinin vëzhgues: A është e vërtetë se rabini ngjitet në qiell për çdo ditë? U përgjigjet: Po, ai me të vërtetë ngjitet edhe më lartë se qielli!*

Jo vetëm dikur por edhe sot e kësaj dite njeriu është i preokupuar me ambicie egocentrike, të ketë dhe të jetë në qendër të vëmendjes para të tjerëve. Bibla në mënyrë figurative përshkruan njeriun e tillë që përjashtohet nga



parajsa. Gjithashtu kemi Kainin dhe Abelin, që vazhdon sot e kësaj dite. Kriza në Lindjen e Afërme, Afganistani, Iraku, Palestina, Libani, Sudani, pasiguria në Evropë dhe në Amerikë, bile i kërcënohen edhe papës etj. Të menduarit e tillë për të pasur: pushet, para, fuqi jo vetëm se e mashtrojnë njeriun por e shpilen në një rreth magjik (djallëzor) që nuk i shihet dalja. Kurse Jezusi në kontekstin e sotëm na ofron një rrugë tjetër, ndoshta e pakuptueshme: *Biri i njeriut nuk erdhi për të qenë shërbyer, por që ai të shërbejë e të japë jetën e vet si shpërblim për të gjithë.*

Ky rresht jo vetëm se shfaqë programin ideorë të Jezu Krishtit, por edhe vetëdijesimin e plotë, që nuk është asgjë tjetër përveç identiteti i të krishterit. Po qe se dëshirojmë ta kuptojmë, duhet të fillojmë me leximin e parë që na sjelli Isaia profet: mbi Shërbëtorin e Jahves: *i përbuzur, më i mbarami ndër njerëz, njeri dhimbjesh, i regjur me vuajtje.. (...) e jep jetën e vet fli shpërblyese* (Is 53,10-11). Nga kjo del profili i fshehtë i njeriut shërbëtor, që e merr ftesën e veçantë nga Hyji, që vihet në shërbim me shpirt e me trup detyrës që e kryen si dëshmitarë i të vërtetës së Zotit, duke flijuar vetën për të tjerët. Në këtë strukturë të profecisë aktualizohet identiteti i Jezu Krishtit. Tani edhe ne në shekullin e 21 gjendemi para kësaj sfide. A do të zhytemi në identitetin e Jezusit nëpër mes pagëzimit, apo do të kërkojmë vendet e para siç kërkuan bijtë e Zebedeut, suksesin, lëvdatat, çmimet e para, laureatë etj.

Në mendësinë konsumuese a mundet të jetë më e vlefshme shërbimi ndaj tjetrit, fjala bie, burri t'i shërbej gruas, prindërit fëmijëve, në mënyrë figurative *t'u lajmë*

*këmbët.*

Kurse Jezusi sjellë një tjetër kriter (Fil 2,6-11), ta përfundojmë me fjalët e Shën Palit: *Madje unë çmtoj gjithçka si dëm në krahasim me më të madhen të mirë: me njohjen e Jezu Krishtit, Zotit tim...* (Fil 3,8-9). Amen.

### **Lutjet e besimtarëve**

**T'i lutemi Atit të mëshirshëm i cili përkujdeset për popullin e vet, dhe e dërgoi në botë Birin e vet për Shëlbues, t'i lutemi me fe, shpresë dhe dashuri duke thënë së bashku: O Jezu, jeta dhe shëlbimi ynë**

- Ndihmoji Kishës sate, ta kuptojë identitetin tënd, që është në shërbimin e njeriut, për jetën e pasosur, *të lutemi.*
- Nxiti të krishterët që të dinë t'i shërbejnë njëri tjetrit me dashuri, *të lutemi.*
- O Jezus, rruga e vërteta dhe jeta, na mëso si të jetojmë dhe veprojmë në nder të emrit tënd dhe në dobi të njeriut, familjes, shoqërisë, *të lutemi.*
- O Jezus na jep hirin që njeriu i sotëm të dijë t'ia japin kuptimin e vuajtjes, kryqit, sëmundjeve, *të lutemi.*
- Për popujt dhe njerëzit që vuajnë padrejtësi, kufizime, dëbime të ndryshme, që t'i forcosh në këto sprova, *të lutemi.*
- Na largo tundimet e lëvdatave, pozitave, karrierave dhe çdo lloj të egocentrizmit, dhe egoizmit, *të lutemi.*

**Ndezi zemrat tona me identitetin tënd të pagëzimit si dhe me flakën e dashurisë sate, që gjithnjë të mendojmë sipas frymëzimeve tua dhe të veprojmë për dashurinë tënde duke i shërbyer njeriut. Ti që jeton dhe mbretëron për amshim.**

**Don Nosh GJOLAJ SDB**

## E Diela XXX gjatë vitit

*Rabbuni! Që të shoh!*

**Leximi i parë:** *Jer 31, 7-9.* Jeremia ngushëllon popullin e vet duke paralajmëruar ditë më të mira.

**Psalmi 126 (125):** *Punë të mëdha bëri Zoti për ne.*

**Leximi i dytë:** *Heb 5,1-6.* Na flet për shërbimin meshtarak të Zotërisë sonë Jezu Krishtit.

**Ungjilli:** *Mk 10,46-53.*

*Në atë kohë, kur Jezusi po dilte prej Jerihonit bashkë me nxënës e me një turmë të madhe populli, biri i Timeut, Bartimeu i verbër, rrinte në anë të rrugës e lypte. Posa mori vesh se ishte Jezusi Nazarenas, filloi të bërtasë: “Jezus, Biri i Davidit, ki mëshirë për mua!” Shumëkush e qortonte të heshtte, porse ai bërtiste edhe më fort: “Biri i Davidit, ki mëshirë për mua!” Jezusi zuri vend e tha: “Thirreni!” Ata i bën zë të verbrit dhe i thanë: “Mos u tremb! Çohu se po të thërret!” I verbëri hodhi mantelin e vet, menjëherë u ngrit dhe shkoi te Jezusi. Jezusi e pyeti: “Çka dëshiron të bëj për ty?” “Rabbunni! Që të shoh!” përgjigji i verbëri. Jezusi i tha: “Shko lirisht! Feja jote të shpëtoi!” Dhe aty për aty pa e vu të udhëtojë mbas Jezusit.*

**Fjala e Zotit**



Krishti është drita e botës, që ka ardhur për t'iu dhënë dritën atyre që jetojnë në errësi. Jezusi sigurisht e kishte parë këtë të verbër që kërkonte mëshirën e tij. Por, duket se Krishti dëshiron ta shoh besimin e tij, ta dëgjojë zërin e tij, disi ta ndjejë dëshirën e tij të kahmotshme: që të shoh! I verbëri nuk frikësohet, edhe kur të tjerët e qortojnë! Ai vazhdimisht, me këmbëngulje, i bindur se vetëm Krishti mund t'i ndihmojë, e kërkon duke e thirrë mëshirën dhe dashurinë e Krishtit. Pra, i verbëri beson se vetëm ky njeri që po kalon nëpër rrugët e botës, mund t'ia kthen të pamurit. Dhe besim i tij i forte shpërblehet me rifitimim e dritës të pamurit. Nganjëherë vuajtja, e cila na përcjellë si hija dhe në forma të ndryshme, na bën të pyesim: Pse? Dhe rrallë here na bën të kërkojmë mëshirë! Vuajtja, thoshte Papa Pali VI është izoluese, ndërsa për Krishtin është një pike takimi, është një bashkim me njerëzimin. A mendoni, ju vëllezër dhe motra, ju të sëmurë, ju të lodhur nga vuajtja, ju të vetmuar dhe të nëpërkëmbur, se gjithçka mund të na mungojë, por Krishti jo?! Ai është me ju! Ai është me ne! Për më tepër, Ai është për ne! Njerëz të pashpresë, njerëz që mendoni të rifitoni paqen e zemrës duke shtypur në brendinë tuaj shqetësimet e ndërgjegjes, të cilat kurrë nuk mund të asgjësohen, nëse ia ktheni shpinën Krishtit. Të marrim guximin edhe ne të shkojmë pas tij, ta pranojmë se pa Krishtin edhe ne jemi të verbër shpirtërisht. Le të kuptojmë se edhe ne

kemi nevojë për mëshirën e tij. Krishti na flet për mëshirë, për dashuri, na fletë për ringjallje, thoshte Papa Pali VI, të Premten e Madhe të v 1971.

Bartimeu, sapo rifiton të pamurit, në të ndryshon edhe vizioni tij për njerëzit, për jetën. Ai vendosë të shkojë pas Krishtit. Nga verbëria fizike, futet në vizionin e së vërtetës hyjnore.

Fal Zotit ne e kemi dritën e syve. Sa jemi mirënjohës për këtë dhuratë të mrekullueshme? Të shohësh do të thotë të jesh pjesëmarrës i gëzimeve dhe bukurive të jetës. Mund të ndodhë të jesh *i verbër me sy çelë*, që mos ta shohësh të mirën, vëllain njeri, mos të shohësh hirin dhe

dashurinë e Zotit. Një zemër e verbuar rrezikon të rëndojë dhe verbojë tërë njeriun. Kjo është verbëria më e rrezikshme. Pra, verbëria më e madhe është ajo kur nuk dëshiron të shohësh tjetrin. Mjerisht ka shumë të verbër të tillë që nuk i shohin të afërmit që kanë nevojë për ne dhe nuk kemi mëshirë ndaj tyre, siç pati Krishti në ungjillin e sotëm. Prej kësaj verbërie duhet të frikësohemi secili prej nesh. Kjo verbëri e errëson botën. Kjo verbëri e ndan dhe e përçan njerëzimin, sjellë të keqën. Me ndihmën e Krishtit jemi të ftuar ta luftojmë këtë verbëri e të përcaktohemi për një jetë në dritën e Krishtit. Amen.



### Lutjet e besimtarëve

**Vëllezër dhe motra, ta thërrasim Krishtin, si i verbëri i Jerihonit, me fe, shpresë dhe dashuri, që t' i pranojë dhe realizojë lutjet tona, duke thënë: *O Zot, na dëgjo.***

- Për Kishën, që gjithmonë e gjithkund të jetë zëri që iu del në ndihmë nevojtareve, *të lutemi.*
- Për bashkësinë tone që duke u rritur në fe, shpresë dhe dashuri, të jetojë nën dritën Tënde, *të lutemi.*
- Për të sëmurët dhe të vuajturit, që të gjejnë paqen, ngushëllimin dhe dritën e shpirtit, *të lutemi.*
- Për të vdekurit tanë, që duke iu falur mëkatet, të gëzojnë Dritën e amshuar në Mbretërinë Tënde, *të lutemi.*

**O Atë, ndihmona ta gjejmë në Krishtin kuptimin e jetës dhe së bashku me Të, të ecim drejtë Atdheut qiellorë. Nëpër Krishtin Zotin tone. Amen.**

Don Anton UKAJ

## Festat gjatë tetorit

**2.X. Engjëjt e Rojes.** Engjëjt janë krijesat e para të Zotit. Zoti i ka dërguar ata për të na ruajtur neve, duke na përcjellur që nga lindja e deri në vdekje. Për ta na flet Bibla, pra edhe vet Krishti. Një fjalë e urtë thotë: *çdo njeri është engjëll por me një krah, e për të fluturuar nevojitet edhe krahu tjetër.* Festa e sotit na nxit të mendojmë në engjëjt që na ruajnë dhe të jemi engjëj për njëri tjetrin. Pra, lë të pranojmë shoqërinë e tyre e të bashkëpunojmë dhe të bashkëjetojmë në shoqëri me engjëjt.

**4.X. Shen Françesku i Asizit,** lindi në Asizi të Italisë më 1182. në një familje të pasur, nga prindërit Pjetër dhe Pikarda Bernardona. Në atë kohë qëllim i të rinjve ishte të bëheshin kalorës. Kësaj rruge shkoj edhe Shën Frani. Kishte dëshirë që në gjithçka të jetë i pari. Në moshën 20 vjeçare bie rob i luftës për një vit. Kur kthehet, të rinjtë e presin me gëzim. Por Shën Frani nuk ishte më i mëparshmi. Ai në zemrën e vet ndjente një pakënaqësi. Gjatë kësaj kohe sëmuret rëndë. Ai edhe më tepër e ndjen kalueshmërinë e kësaj bote. Megjithatë, si u shërua, u nis rrugës së vjetër të lavdisë dhe suksesit si kalores. Mirëpo në ëndërr një zë i thotë që *më mirë të dëgjojë zotërinë se sa shërbëtorin.* Shën Frani duke besuar se po e thërret Zoti kthehet në Asizi. Vendosi të largohet nga jeta e më hershme dhe t'i përkushtohet lutjes. E konsideronte veten mëkatar të madh dhe bënte shumë pendesë. Derisa një ditë lutej në kishën e Shën Damjanit, tri herë e dëgjoji zërin e Krishtit: *Franë, shko rindërtoje kishën që po rrëzohet!*

Dhe ai e renovoi kishën e Shën Damjanit dhe kapellen e Zojës së Engjëjve. Por Krishti mendon në renovimin e kishës së gjallë. Kjo rikthesë e Franit, e iritoi tej mase babën e tij. Ai kurrë nuk e pengoi djalin e vet që të argëtohet, e të harxhojë pasurinë e tij. Por tash kur e sheh djalin e vet duke agjëruar, bërë pendesë dhe duke jetuar krejtësisht për Zotin, hidhërohet shumë. U mundua në çdo mënyrë ta largonte prej kësaj rruge, por pa sukses. E akuzoi në gjyq të kishës dhe të shtetit. Dhe para të gjithëve, Shën Frani, botërisht deklaroi: *O Zot, baba im nuk me do me. Une nuk e dua pasurinë e tij. Ja po ia japi edhe teshat e trupit. Tash e tutje vetëm Ti je Ati im. Unë nuk kam nevojë për pasurinë e tij. Jam krejtësisht i yti, o Atë!* Dhe nga ky moment, Shën Frani filloj të predikojë ungjillin dhe të bëj revolucion në popull, që kthehej kah Zoti pasi dëgjonin predikimet e Shën Franit. Ai fjalët e veta i konkretizonte me vepra. Kështu shpejt iu bashkëngjiten të rinjtë



tjerë. Ai nga përvujtëria dhe frika nuk deshë të bëhej meshtarë, por mbeti xhakon. Të rralla janë zemrat që jetuan për Krishtin, siç ishte Shën Frani. Ai i kishte edhe varret e Krishtit në trup. Ai themeloi rregullin françeskanë, një Urdhër rregulltarësh dhe një Urdhër të Tretë personash pendestarë, që të jenë laikë, pra të jetonin në botë. Vdiq 4.X.1226, në moshën 44 vjeçare. Shenjtë e shpalli papa Gregori IX. në 1229, ndërsa Papa Piu XII e shpalli Mbrojtës të Italisë më 18.VI.1939.

**7.X. Zoja Rruzare** Kjo festë u themelua nga Papa Piu V. Forcat turko otomane, superfuqi e kohës, depërtonin gjithnjë e më tepër drejt Perëndimit duke rrezikuar edhe Romën. Në Lepanto duhej të zhvillohej beteja vendimtare. Ushtria e krishterë, e përkrahur edhe nga vetë Papa, ishte numerikisht dhe ushtarakisht më e

dobët. Papa kërkoi nga të krishterët që me uratë në dorë të kërkojnë ndihmën e Nënës qiellore. Dhe Ajo nuk i zhgënjeu. Ushtria e krishterë doli fituese dhe kështu shpëtoi Evropa Perëndimore nga pushtimi turk. Kurrë më ata nuk iu afruan dyerve të Evropës, si këtë herë. Dhe Papa Piu V në përvjetorin e fitores detare të korrur nga të krishterët në Lepanto (1571) e themeloi këtë festë. Festa na nxitë që duke lutur rruzaren shenjte të meditojmë mbi misteret e Krishtit nën udhëheqjen e Marisë, e cila ishte e lidhur në mënyrë të veçantë me Shelbuesin tonë me mishërim, me mundimet dhe lavdinë e ringjalljes së Birit të Zotit dhe të vetin. Muaji tetor i është kushtuar Zojës Rruzare. Le të gjejmë kohë për ta lutur rruzaren në familje tona.

Don Kristë **GJERGJI**

### Kronika

**Letnicë, 5.IX.2006.** U kremtua festa e të Lumes Nënës sonë Tereze. Meshën e rastit e udhëhoqi Imzot Zef Gashi, në bashkëmëshim me shumë vëllezër meshtarë. Lë të theksojmë se pjesëmarrja e besimtarëve ishte e vogël, ndoshta në mungesë të organizimit të mirëfilltë.

**Letnicë, 8.IX.2006.** U kremtua Lindja e Zonjës së Bekuar, në një atmosferë vërtetë festive. Meshën e rastit e udhëhoqi p Anton Nua, gardian në Gjakovë.

**Ferizaj, 11.IX.2006.** Ishte mesha për nder të viktimave të 11 shtatorit 2001. Në meshë morën pjesë KFOR i amerikan, kryetari komunës dhe shumë përfaqësues të tjerë nga komuna e Ferizajit.

**Ferizaj, 14.IX.2006.** Ishte varrimi i meshtarit tone don Jakë Prenkut. Në varrim morën pjesë 36 meshtarë në krye me ipeshkvin Mons Zef Gashi, dhe shumë rregulltarë. Me keq ardhje duhet të themi se pjesëmarrja e besimtarëve ishte e vogël?!

**Shkodër, 23.IX.2006.** U mbajt finalja e e festivalit *Kush këndon, lutet dy here*. Radhitja: 1. Shkodra.2. Durrësi.3. Ferizaji. Urime!

## Virtytet

Përkumeria: mos ha dhe mos pi deri në fund.

Qetësia: Fole atë që kanë dobi të tjerët dhe ti, largohu nga fjalët e pahijshme.

Rregulli: Çdo gjë lë ta ketë vendin e vet: për çdo punë merr kohë.

Vendosmëria: Atë që është e nevojshme bëje me vendosmëri, vendimin tënd kryeje pa gabime.

Kursimi: Mos harxho më tepër se ju nevojitet tjerëve, asgjë mos hudh.

Angazhimi: Mos humb kohë, gjithmonë merru me gjëra të dobishme.

Çiltëria: Mos e përdorë dredhinë që dëmton, mendo mirë dhe drejtë, ashtu vepron.

Drejtësia: Mos dëmto të tjerët, mos i lë anash punët që të takojnë.

Gjakftohtësia: Largoju ekstremeve.

Pastërtia: Kujdes në pastërtinë e trupit, gardërobës, banesës, sidomos të shpirtit.

Qetësia: Mos u shqetëso për punë të vogla ose gjërat e paevitueshme.

### **A e dini se...**

- Njëpërmjet letrës që dërgon më 22.VII 1880. Foreign Office- it, Lord Fitzmaurice, duke kundërshtuar pretendimet e ngritura prej serbëve për origjinën e banorëve të Mitrovicës dhe Kosovës, thekson se të gjitha hartat me të cilat është konsultuar, dëshmojnë për një origjinë shqiptare dhe jo sllave të këtyre viseve. Ndonëse këto vise përfshiheshin në mbretërinë e vjetër serbe, banorët vendas të këtyre viseve sipas Hahnit, konsullit austriak të Janinës, kanë qenë shqiptarët e shpronësuar prej serbëve në shek. XIV.

- Në letrën për kardinal Gonzadion, relacion i shtatorit të vitit 1621, Pjetër Budi, ipeshkëv thekson: *...që t'u vihet sadopak në ndihmë për t'u çliruar dhe jo vetëm të krishterët, por edhe vetë të parët e tyre myslimanë e fe lëshuesit nga mosdurimi i tiranisë otomane, e prandaj secili ka dëshirë të çlirohet njëherë e mirë nga një mjerim i tillë ose të vdesë me armë në dorë...*

- Në raportin e konsullit malazez në Shkodër dërguar qeverisë së tij, më 15.III.1900 shkëpusim: *Edhe libra, edhe fletushka jepen falas. Kush paguan? Kuptohet se Austria. Autorët e këtyre pamfleteve janë të një komiteti të patriotëve shqiptarë e këta janë: Abati i Mirditës Padre Zubaq dhe dy priftërinj: dom Mark Shllaku dhe don Nikolla. Ky komitet po harton edhe libra shkollorë, për shkollat që Austria mendon t'i hap nëpër fshatra. Në shkolla do të mësohet vetëm gjuha shqipe dhe do të rritet edhe më tepër urrejtja ndaj nesh.*

- Himni i Flamurit është këngë që i kushtohet atdheut dhe që simbolizon njësinë e kombit dhe të shtetit tonë. Himni i Flamurit tone u krijua nga atdhetarët e kolonisë shqiptare të Bukureshtit, prej ku e solli në Shqipëri Hil Mosi. Vjersha është e Asdrenit. Himnin e mësoi dhe i pari e këndoi në Vlorë me rastin e Shpalljes së Pavarësisë grupi koral i Korçës. Prej asaj kohe mori përhapje dhe u bë himni kombëtar i shtetit tonë.

## Studentët tanë në Itali

Tash disa vite famullia *Engjëlli Rojes* nga Ferizaji është e binjakëzuar me famullinë *Santa Maria Regina* në Terni të Italisë. Falë këtij binjakëzimi dhe famullitarit Mons Sandro Sciaboleta, ne kemi arritur të zhvillojmë shumë veprimtari të ndryshme. Lë të themi se iniciator për këtë binjakëzim ishin disa familje të Ferizajt që gjatë luftës ishin strehuar në këtë famulli italiane. Bashkëpunimi mes dy famullive fillojë me binjakëzimin e disa familjeve italiane me ato kosovare. Këto familje edhe sot e kësaj dite materialisht ndihmojnë 50 familje kosovare, pa dallime fetare dhe kombëtare. Më pas duke e pare gjendjen e rendë shëndetësore në Kosovë, dhe fal angazhimit të Mons Sandros, në ambulancën e Karitasit të Kosovës fillojnë të vijnë mjekët italianë, të cilët filluan t'i marrin për mjekim në Itali pacientët kosovarë me sëmundje të pashërueshme në Kosovë. Kështu deri më tani kemi arritur t'i dërgojmë rreth 40 pacientë në Itali. Dhe fatmirësisht të gjithë janë kthyer me shërim të plotë. Mons Sandro me miqtë e vet ka ndihmuar shumë edhe spitalin e qytetit me aparatura dhe donacione të ndryshme, Poashtu fal këtij bashkëpunimi të frytshëm, që tri vite radhazi kemi arritur të organizojmë ekskursionet me fëmijë në Itali. Gjatë këtyre vizitave, përveç Ternit, kemi vizituar edhe Asizin, shenjtëroren e Shën Franit, Peruxhen, sivjet edhe Padoven dhe natyrisht Romen. Në *Qytetin e amshuar*

kemi pas fatin të takohemi edhe me Papën Benediktin e XVI dhe të lutemi para varrit të Shën Pjetrit dhe të papa Gjon Palit II. Duke e pare bashkëpunimin e frytshëm mes dy famullive, kemi pare të udhës që të ndihmojmë edhe në binjakëzimin e dy qyteteve tona. Kështu pra tani janë të binjakëzuar edhe Ferizaji me Ternin. Sivjet kemi bërë edhe një hap shumë të rëndësishëm për ardhmërinë tonë. Mendoj se për here të pare në historinë e Kosovës, jashtë shtetit tone shkojnë për t'i vazhduar studimet 15 studentë të rinj nga Ferizaji, në mesin e të cilëve edhe pesë besimtarë tanë. David Kurti, Trilinda dhe Arlind Demaj (vëlla dhe motër), do të studiojnë mjekësinë, ndërsa Anita Gashi dhe Aurelia Ukaj ekonomikun. Derisa e falënderojmë mikun tone të madh Mons Sandron për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në të gjitha këto projekte madhore, studenteve tanë ju dëshirojmë suksese në mësimet.



*Kisha në Terni - Itali*



Impresum: Ad usum Internum

Boton; Dekanati i Prishtinës

Adresa: Rr. "Rexhep Bislimi" Nr. 50, Ferizaj

E-mail: [jetaliturgjike@hotmail.com](mailto:jetaliturgjike@hotmail.com)

Tel.0290/20-041

Shtypi: "ERA" Ferizaj



*Engjëlli i Rojes - Ruajna ne*